**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE**
**PLANI GJITHPËRFSHIRËSE I KOMUNAVE 2019**

| | | |
|---|---|---|
| **Data e dorëzimit të raportit:** | 20.12.2019 | |
| **Emri i komunës** | Prishtinë | |
| **Emri i Kryetarit të Komunës** | Shpend Ahmeti | |
| **Emri i Zyrtarit Komunal për IE :** | Ajshe Berveniku | |
| **Detajet kontaktuese:** | **E-mail:** ajshe.berveniku@rks-gov.net<br>**Tel:** 044/ 144 - 303 | |
| **Informata të përgjishme mbi zhvillimin e proceseve të Integrimeve Evropiane në komunen tuaj?** | 1. A është themeluar zyra komunale për Integrime Evropiane në komunën tuaj konform Rregullores Nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integrim Evropian?<br><br>2. A vepron ZKIE në kuadër të Zyrës së Kryetarit?<br><br>3. A e ka udhëheqësin e zyrës ZKIE-a?<br><br>4. Sa zyrtarë janë në këtë zyre?<br><br>5.A ka zyrtari/zyra komunal për integrime Evropiane plan vjetor të punës ?<br><br>4. A ka ndonjë mekanizëm tjetër komuna juaj (p.sh grup punues) nga drejtoritë përkatëse të cilat janë të obliguara të raportojnë në obligimet e Agjendes Evropiane në të cilat diskutohen arritjet dhe sfidat e përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane në komunën tuaj, nëse po sa takime janë mbajturë gjatë kësaj periudhe ?<br><br>5.Obligimet e komunës suaj të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, a janë të inkorporuara në planin vjetore të Drejotorive përkatëse si dhe | 1. Komuna e Prishtinës ka themeluar sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integrimeve Evropiane. Në kuadër të këtij sektori do të zhvillohen bashkëpunimet ndërkomunale, komunale ndërkombëtare si dhe do te mbulojë sferën e integrimeve evropiane. Udhëheqësja e sektorit është emëruar me 15.06.2018;<br><br>2. Në Komunën e Prishtinës është emëruar udhëheqësi i sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrime evropiane.<br><br>3. Në Komunën e Prishtinës është një (1) zyrtare për integrime evropiane.<br><br>4. Zyrtarja për integrim evropian mban kontakte të rregullta me drejtorët e drejtorive si dhe shefat e sektorëve përkatëse, sa i përket përmbushjes së veprimeve qe dalin nga PKZMSA – ja. Takimet mbahen sipas nevojës, po ashtu Shefja e sektorit merr pjesë në |

| | | |
|---|---|---|
| | a është ndarë buxhet për realizimin e këtyrë obligimeve?<br><br>6.A merr pjesë Zyrtari për Integrime Evropiane në takimet që mbahen për planifikim të buxhetit vjetor/në mënyre që të ketë një monitorim më efikas mbi përfshirjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane në planet e punës se drejtorive Komunale dhe planifikimin buxhetor të atyre planeve . | takimet e bordit të Drejtorëve;<br><br>5. Shumica e obligimeve janë pjesë e Planit të Komunës, buxhet nuk është ndarë meqë obligimet e caktuara i përkasin drejtorive të caktuara dhe për ato veprime është ndarë buxheti në kuadër të drejtorive përkatëse;<br><br>6. Udhëheqësja e sektorit BND dhe integrime evropiane merr pjesë në mbledhjet për planifikim buxhetor;<br><br>7. Zyrtarja për IE siç është cekur edhe tek pika 4, mban takime me drejtorët dhe shefat e sektorëve konkret, po ashtu i mban të informuar Kryetarin dhe nënkryetarët për veprimet e paplotësuara dhe e shqyrtojnë mundësinë e gjetjes së zgjidhjes, po ashtu shfrytëzon edhe AKK përmes Kolegjiumit që të arrihet zgjidhja për veprimet e paplotësuara; |

| Objektivat | Drejtoria komunale përgjegjëse | Masat | Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit Janar – Dhjetor 2019 | Dispozitat e MSA-së |
|---|---|---|---|---|
| 1. **<u>BLLOKU I: KRITERET POLITIKE</u>** | | | | |
| **1. ADMINISTRATA PUBLIKE** | | | | **Neni 120 i MSA-së: Administrata publike** |
| 1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal | **Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ Zyrat dhe Sektorët** | 1. A është hartuar programi trajnimeve për vitin 2019 në komunën tuaj? Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë. Nëse jo, ju lutem shpjegoni arsyet.<br><br>2. Sa është numri trajnimeve të mbajtura sipas fushave dhe numri i zyrtarëve të trajnuar ?<br><br>3.A posedon komuna juaj databazën për meaxhimin e programit të trajnimeve?<br><br>4.Sa zyrtarë të rinjë janë punësuar në | 1. . Sektori i Burimeve Njerëzore ka hartuar Planin e trajnimeve për vitin 2019;<br>2. Sipas të dhënave që posedon Sektori i Burimeve Njerëzore gjat periudhës raportuese jan mbajtur 12 trajnime në këto fusha:<br>- Prezantimi i pakos ligjore per transparencë komunale;<br>- Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve;<br>- Liderët kundër mosdurimit dhe ekstremizmit të dhunshëm;<br>- Teknologji Informative në temën ,, Microsoft Access 2013";<br>- Puntoria “Prezantimi i pakos ligjore për transparencë komunale”;<br>- Menaxhimi i pronave publike;<br>- Teknologji Informative në temën ,, e-Qeverisja & m-Qeverisja";<br><br>- Bashkëpunimi nder komunal në fushën e | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | administratën e Komunës suaj gjatë periudhës raportuese. Ju lutemi ofroni listën e të punësuarve, pozitat e tyre dhe departamentet/ zyrat në të cilat janë punësuar? | zhvillimit ekonomik;<br>- Të Drejtat e Njeriut Shërbimet Sociale dhe Familjare;<br>- Administrata dhe Qeverisja e mirë;<br>- Buxheti dhe Huamarrja Komunale;<br>- Menaxhimi i taksave dhe planifikimi i të hyrave vetanake.<br>Gjithsejt 23 zyrtarë kanë marrë pjesë në trajnimet e lartcekura;<br>3. Sektori i Burimeve Njerëzore ka vetëm një data bazë të thjeshtë vetëm për mbajtjen e evidencës për aq trajnime sa ne jemi të njoftuar si zyre;<br>Në Komunën e Prishtinës gjatë periudhës raportuese janë punësuar njëzeteshtatë (27) nëpunës, në këto drejtori:<br>- Drejtorinë e Sherbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpetim;<br>- Drejtorinë e Inspekcionit;<br>- Drejtorinë e Prones;<br>- Drejtorinë per Investime Kapitale dhe Menaxhim te Kontratave;<br>- Drejtorinë e Administratës;<br>- Drejtorinë e shëndetësisë;<br>- Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qendrueshëm;<br>- Drejtorinë e Kadastrit dhe<br>- Kabinetin e Kryetarit<br>Pozitat e të punësuarve janë:<br>-Asistent Administrativ 3 – janë tre nëpunës në këtë pozitë;<br>-Zyrtare e te hyrave financiare;<br>-Zyrtar I lartë për energjetikë;<br>-Zyrtar I lartë për makineri; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | -Inspektor i shërbimeve publike<br>-Zyrtar për shërbim me qytetar;<br>-Zyrtar për shëndetësi;<br>-Zyrtar për zhvillim;<br>-Zyrtar i lartë për burime njerëzore;<br>-Zyrtar i lartë për kadastër dhe<br>-Zyrtar i gjendjes civile.<br><br>**Sektori për bashkëpunim Ndërkombëtarë dhe Integrime Evropiane**<br><br>Zyra për Integrime evropiane në bashkëpunim me "Yong Cell Scheme" ka organizuar trajnimin tre ditorë me temën**: "Integrimet evropiane dhe përmbushja e kritereve të MSA-së në nivel lokal të qeverisjes"** data 29 - 31 Maj 2019.<br><br>Në trajnim morën pjesë 23 nëpunës/e, u ndanë certifikata për pjesëmarrës. | |
| 1.2.Të zbatohet legjislacioni dhe politikat për reformën e administratës publike | **Zyra e personelit** | 1.A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e tri ligjeve kornizë për reformën e adminsitratës publike (*Ligjit për zyrtarët publilkë, Ligjit për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura*, dhe *Ligjit për Pagat në Sektorin Publik*)? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e | 1. Gjatë periudhës raportuese nuk kemi ndërmarrë asnjë aktivitet lidhur me *Ligjin për zyrtarët publilkë, Ligjin për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura*, dhe *Ligjin për Pagat në Sektorin Publik*.<br><br>3. Komuna ka pranuar raportin e auditimit për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018. Zyra Kombëtare e Auditimit ka konstatuar se raporti paraqet pamje te drejtë dhe vërtetë të pasqyrave financiarë dhe ka vlerësuar me opinion të Pamodifikuar që nënkupton një | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ndërmarra.<br><br>2. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për ngritjen e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e menaxhimit të financave publike? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra.<br><br>3. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtarë e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuj. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar dhe sa prej tyre kanë mbetur pa u adresuar? Ju lutemi shpjegoni.<br><br>4. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për përmirësimin e transparencës dhe qeverisjes së ndërmarrjeve publike që funksionojnë në territorin e komunës suaj? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e | opinion Pozitiv sa i përketë aktiviteteve financiare gjatë vitit 2018. Mirëpo, përkundër faktit që kemi një opinion të pamodifikuar kemi me theksim të çështje që është problem i shpenzimeve të mjeteve nga Investimet kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.<br>- Për vitin 2018 kemi gjithsejtë 21 rekomandime, që janë 5 rekomandime më pak se vitin e kaluar. Komuna më të marr raportin nga ZKA ka hartuar menjëherë planin e veprimit për rekomandimet e paraqitura, ku janë caktuar personat përgjegjës për t'i implementuar. Pesë rekomandime janë implementuar menjëherë dhe 7 shtatë janë duke u impelmentuar.<br>4. Në këtë periudhë, Komuna e Prishtinës ka siguruar që në 3 procese të përzgjedhjes së Anëtareve të bordit dhe 2 Kryeshefëve te kenë transparence të plotë përmes prezencës së Projektit Britanik për Rekrutimin e Pozitave të Larta Drejtuese (BDO);<br><br>Përmes komisionit komunal të aksionareve ka bërë përzgjedhjen e anëtareve të bordit ne tri Ndërmarrjen Publike: "Prishtina Parking" ," Ndërmarrjen Publike Banesore " dhe "Stacionin e autobusëve" . Gjithashtu, kryeshefëve ekzekutiv në "Stacionin e Autobusëve" dhe "Termokos" janë përzgjedhur me proces të hapur dhe transparent, ku monitorues të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ndërmarra. | procesit sipas marrëveshjes së Komunës së Prishtinës me Ambasadën Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë ishin përfaqësues nga Projektit Britanik për Rekrutimin e Pozitave të Larta Drejtuese (BDO);<br><br>Vendimi për përzgjedhjen e kandidateve të suksesshëm ishte në harmoni të plotë në mes të aksionarëve dhe BDO;<br><br>I gjithë procesi i rekrutimi është monitoruar nga përfaqësuesit e Projektit Britanik për Rekrutimin e Pozitave të Larta Drejtuese. Vlerësimi i kandidatëve me notimin më të lartë do të publikohet edhe në web faqën e Projektit Britanik; | |
| 1.3.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal | **Drejtoria e Administratës/Sektori i Kuvendit/ Zyra për Informim/** | 1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?<br><br>2.Sa është numri i kërkesave për qasje në dokumente publike?<br><br>3. Sa është numri i kërkesave të aporvuara | 1. Është miratuar Plani i Veprimit për Transparencë;<br><br>http://prishtinaonline.com/dokumente/vendimet/vendimet-2019<br><br>2. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike është 67;<br><br>3. Numri i kërkesave të aprovuara është 61; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | për qasje në dokumente publike?<br><br>4. Sa është numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike?<br><br>5. A janë publikuar në ueb faqen e komunës tuaj të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga organet e komunave në gjuhët zyrtare (nëse jo, ju lutem jepni arsyet e mos publikimit në gjuhët zyrtare) ?<br><br>6. A janë duke u transmetuar mbledhjet e kuvendeve perms ueb faqes komunale ?<br><br>7. A ka forma të tjera të transmetimit të mbledhjeve të kuvendeve ?<br><br>8. Sa takime publike gjithëpërfshirëse me qytetarë janë mbajtur gjatë peridhës raportuese (konform nenit 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje | 4. Numri i kërkesave të refuzuara është 6 (pasi të dhënat e kërkuara kanë qenë të mbrojtura me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale);<br><br>https://prishtinaonline.com/qasja-ne-dokumentet-zyrtare<br><br>5. Po<br><br>6. Po<br>https://prishtinaonline.com/kuvendi<br><br>7. Po, përmes rrjeteve sociale;<br><br>8. https://prishtinaonline.com/uploads/debatet_2019%20(1).pdf<br>9. Janë organizuar diskutimet publike nëpër lagje të ndryshme, janë lajmëruar qytetarët përmes mediave të shkruara dhe elektronike, si dhe përmes rrjeteve sociale. Janë shpërndarë njoftimet edhe nëpër bashkësi lokale e nëpër vende të frekuentuara. Deri me tani janë mbajtur 19 diskutime publike;<br><br>10. Komuna e Prishtinës e ka platformën digjitale ku qytetarët kontribuojnë me ide 24h/7, ku të gjitha kërkesat merren parasysh për planifikimet e buxhetit për | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | lokale)? [1]<br><br>9. Sa takime konsultative me qytetarë janë mbajtur lidhur me propozim-aktet e kuvendit të komunës (rregullore, statute, plane etj)?<br><br>10.A ka ndërmarrë Komuna juaj veprime për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në Konsultime publike? Nëse po qfarë veprime ka ndërmarrë?<br><br>11.Cilat janë vështirësitë të cilat ndikojnë në zbatimin e ligjeve, Rregulloreve, politikave dhe procedurave tjera në Komunën tuaj? Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë komuna juaj në këtë drejtim? | vitin e ardhshëm; https://platformadigjitale.com/Prishtina/<br><br>11. NA | |

[1] Neni 68.1 I Ligjit për vetëqeverisje lokale obligon së paku 2 takime publike në vit në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1.5.Të zbatohet në mënyrë sistematike rekrutimi i stafit civil i cili është bazuar me ligj | **Drejtoria e Administratë s/Zyra e personelit** | 1. A është themeluar komiteti për komunitete në komunën tuaj konform Ligjit për Barazi Gjinore (nenit 6 paragrafi 7 dhe 8).<br><br>2. Sa mbledhje të këtij komiteti janë mbajtur në periudhën raportuese?<br><br>3. A është emëruar nënkryetari i komunës për komunitete?<br><br>4.A eshte ndërmarr ndonje veprim per te ndaluar ndikimin politik në rekrutimin e pozitave të larta të shërbimit civil dhe rekrutimet jo-meritore? Nëse po, cilat janë veprimet?<br><br>5.Sa është përqindja e popullësisë jo shumicë në komunën tuaj ?<br><br>6. Sa është përqindja e të punësuarave të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike? | 1. Po, me datë 07.03.2018 është themeluar Komiteti për Komunitete;<br>2. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjashtë 11 takime, është i planifikuar takimi i 12;<br>3. Jo nuk është emëruar nënkryetari për Komunitete;<br>4. Në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës nuk kemi zhvilluar procedurë të rekrutimit për pozita të larta;<br>5. Statistikat e Kosovës ( e kemi diskutuar si çështje ne takimin konsultativ);<br><br>6. Përqindja e të punësuarve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Prishtinës është 3.47%; | Sqarim<br>5. Statistikat e Kosovës ( e kemi diskutuar si çështje ne takimin konsultativ); |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **2. AVOKATI I POPULLIT** | | | | |
| 2.1.Të përmirësohen kushtet për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit | **Drejtoria e Administratës** | 1.Sa ëshë numri i insitucioneve publike lokale në komunen tuaj? 2. Sa prej tyre kanë qasje të përshtatshme për persona me aftësi të veçanta? | | |
| 2.2. Të zbatohen rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit | **Njësia për të Drejtat e** | 1.Sa është numri i kërkesave/rekomandimeve të cilat Komuna i ka pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit ( nëse po listoni ato), si dhe cilat | 1. Gjate periudhës raportuese janar – dhjetor 2019 zyra ligjore nga Avokati i Popullit ka pranuar 16 kërkesa dhe 1 rekomandim nga Avokati i Popullit; Nga 16 kërkesat e pranuara, Zyra Ligjore ka kthyer 10 përgjegje, ndërsa 6 janë në shqyrtim; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Njeriut dhe Komunitete** | janë masat që komunat kanë ndërrmarë lidhur me rekomandimet e pranuara?<br><br>2. Sa përgjigje pozitive i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?<br><br>3. Sa përgjigje negative i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?<br><br>4.Sa kërkesa/rekomandime janë në proces të shqyrtimit? | | |
| **3.SHOQËRIA CIVILE** | | | | |
| 3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile | **Drejtoria për Financa dhe Buxhet** | 1. Sa ka ndarë buxhet komuna për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve ?<br><br>2.Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna?<br><br>3.Sa është numri i projekteve që ka | 1. Buxheti i ndarë nga Komuna për OJQ-të dhe OSHC-të për periudhën janar-dhjator 2019 është 2,730,000.00 €;<br>2. Numri i OJQ ve te financuara ne vitin 2019 jane 250;<br>3. Numri i projekteve te financuara ne vitin 2019 është 250;<br>4. Vlera totale e pagesave janar - dhjetor 2019 per OJQ 1.003.647.52€; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | financuar komuna?<br><br>4. Sa është shuma e përgjithshme e realizuar për përkrahjen e aktiviteve të OSHC-ve? | | |
| **4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT** | | | | **Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA** |
| 4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?<br><br>2. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin<br><br>3. A është kërkuar nga Drejtori i Policisë për të | 1. Gjatë raportimit të Komandatëve të Stacioneve të Policisë është diskutuar edhe në këtë fushë për ekstremizmin dhe radikalizmin, që në takimet e radhës do të diskutohet më gjërsisht dhe do të merren hapat e duhur për vetëdisimin e qytetarëve;<br>2. Nuk ka pasur raste të raportuar në KKSB lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin në periudhën njëvjeqare;<br>3. Në të gjitha takimet e KKSB-së është raportuar nga tre Komandatët e stacioneve Policore për gjendjen e Sigurisë në Komunën e Prishtinës, ndërsa sa i përket Kuvendit Komunal gjatë periudhës raportuese nuk kemi pasur asnji rast kur Komandanti i Policisë ka raportuar për ndonjë çështje; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë në Kuvendin e Komunës dhe a është raportuar ? | | |
| 4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1.Sa është numri i personave zyrtar të obliguar për deklarimin e pasurisë tek AKK?<br><br>2.Sa është numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal ?<br><br>3. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?<br><br>4. A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e ndryshimeve më të fundit ligjore për suspendimin e zyrtarëve të dyshuar për | 1. Numri i personave zyrtare që e deklarojnë pasurinë është 79;<br><br>4. Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2019 nuk kemi pasur asnjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal;<br>5. Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2019 nuk kemi pasur asnjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit nga anëtarët e Kuvendit; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | korrupsion, respektivisht atyre të dënuar, për korrupsion (bazuar në ndryshimet më të fundit në *Kodin Penal* dhe atë të *Procedutrës penale*)? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra.<br><br>5. A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e ndryshimeve më të fundit në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës zyrtare? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra.<br><br>6. A ka bërë komuna juaj përgatitje gjatë periudhës raportuese për zbatimin e ndryshimeve më të fundit në legjislacionin për mbrojtjen e informatorëve? Ju lutemi ofroni të dhëna mbi aktivitetet e ndërmarra. | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion; | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2. A ka komuna juaj zyrtar që raporton për Planin Lokal për Integritet ?<br><br>3. Sa është numri i raporteve të publikuara mbi monitorimin e zbatimit të Planit Lokal për Integritet. | 1. Komuna e Prishtinës nuk e ka Planin për Integritet;<br>2. N/A<br>3. N/A | |
| **5. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE** | | | | |
| 5.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 1.Numri dhe lloji i aktiviteteve të komunës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut?<br><br>2. A është miratuar rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëse po ju lutem të bashkangjiteni | 1.Me organizatën Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ) edhe gjatë viti 2019 do organizojmë aktivitete të ndryshme për grupet e margjinalizuara në komunë duke ju përmbajt planit të punës ku jam edhe kryesuese e grupit :<br>Takimet e rregullta mujor si dhe vizita në teren sipas planit ku kemi këto kategori sa i përket vizitave :<br><br>a. Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me substanca narkotike, dalja në orët e vona; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | rregulloren e miratuar?<br><br>3. A ka rritur komuna juaj buxhetin e ndarë për këtë vit për zbatimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejave të njeriut dhe të minoriteteve në raport me vitin 2018? Nëse po, ju lutemi ofroni të dhënat (në shifra absolute dhe përqindje). Nëse jo, ju lutemi shpjegoni arsyet.<br><br>4. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për forcimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteeve? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra.<br><br>5. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për ngritjen e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen dhe | c. Fëmijët në situatë rruge;<br><br>d. Qasja e personave më aftësi të kufizuar;<br><br>Sa i përket aktivitetit për Fëmijët në situata rruge së bashku me Drejtorinë e mirëqenies sociale dhe organizatave partnere që kanë në fokus mirëqenien e fëmijëve jemi në proces për të gjetur një zgjidhje për ti siguruar një qendër ditore për kategoritë e këtyre fëmijëve me qëllim që ti largojmë sa më shumë nga rruga<br><br>Projekti me GIZ ka përfunudar në shtator 2019;<br><br>2.Mbajtja e diskutimeve publike për Rregulloren dhe Planin e Veprimit për Drejtat e fëmijëve . Tani e miratuar edhe në Asamblenë Komunale;<br><br>3. Asambleja Komunale e Fëmijëve është organ legjitim i përfaqësimit të fëmijëve në vendimmarrje në nivelin lokal dhe është ambient ku vazhdimisht promovohen liritë dhe të drejtat e fëmijëve;<br><br>-Në mbledhjen e 5 të Asamblesë Komunale është miratuar për të vazhduar në diskutim publik Rregullorja mbi themelimin dhe strukturimin e Asambleve Komunale të Fëmijëve ( diskutimi publik ka përfunduar tani pritet në mbledhjen e rradhës të hy pikë e rendit të ditës); | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | promovimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteeve? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra. | -Asambleja e fëmijëve ka mbajt takimin e rregullt ku janë zgjedhur komisionet dhe ndarja e përgjegjësive për aktivitet e radhës Komisionet janë organe të përkohshme ose të përhershme, që kujdesen për zbatimin e objektivave të Asamblesë. Komisionet e zgjedhura:<br>a)Komisioni për bashkëpunim me organet profesionale të shkollës, këshillin e shkollës, këshillin e prindërve, mësuesit dhe komunitetin lokal; b)Komisioni për sport dhe kulturë; c)Komisioni për veprim humanitar;<br>d)Komisioni për informim;<br><br>- Hartimi i Planit të Veprimit për Asamblenë e Fëmijëve 2019-2020;<br><br>4 . Takimet e rregullta të Mekanizmit Koordinues kundër dhunës në familje<br><br>Këshillit Komunal kundër dhunës, është themeluar në Korrik të vitit 2015 dhe nga atëherë si koordinatore e grupit organizoj mbledhjet e rregullta ku kemi shqyrtuara rastet e dhunës në familje, trafikimin dhe ngacmimet seksuale, pjesëmarrës janë QPS, Policia e Kosovës, Mbrojtësit e viktimave, Strehimorja, CLARD ndihme juridike falas etj.<br><br>Me 15.04.2019 si Koordinatore e mekanizmit Komunal kundër dhënës në Familje në bashkëpunim me OSBE kemi organizohet takimin e përbashkët të institucioneve | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | përgjegjëse për nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Mekanizmin Koordinuese Kundër Dhunës në Familje<br><br>Qëllimi i kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi është koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në Komunën e Prishtinës, për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare, përmes institucionalizimit të **Mekanizmit Koordinues** .<br><br>Marrëveshja e Mirëkuptimit gjithashtu ka për qëllim përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe efikasitetit për parandalimin, trajtimin dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës në familje, duke siguruar në vazhdimësi mirëqenie për këtë kategori personash që janë viktima të dhunës në familje, përmes institucionalizimit të Mekanizmit Koordinues dhe monitorimit të zbatimit të politikave.<br><br>Koordinatore e grupit në Projektin për të Drejtat Sociale për Grupet Vulnerabël- SoRI në kuadër të bashkëpunimit me Organizatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar- GIZ , organizuam pritjen në vizitë studimore të përfaqësuesve nga Shqipëria (Kukës, Elbasan dhe Librazhd) për të ndarë eksperiencat tona lidhur me zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në kuadër të projektit, "Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale për grupet në nevojë në nivel kombëtar dhe | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | lokal .<br>Në këtë takim i pranishëm ishte edhe drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Dren Kukaj<br><br>Në bashkëpunim me organizatën INPO dhe mbështetje nga organizata gjermane GIZ ku jemi edhe anëtare të grupit SoRI, **në Teatrin Dodona, Prishtinë** kam organizuar të prezantohen dy shfaqje të titulluara, "Çantat e zbrazëta" dhe "Zëri Im" . Këto dy shfaqje janë realizuar në kuadër të projektit "Fuqizimi i përfshirjes së zyrtarëve komunal në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare" të mbështetur nga GIZ .Nëpërmjet shfaqjes teatrale ne kemi menduar të përcjellim mesazh ndërgjegjësues tek të rinjtë në respektimin e të drejtave të secilit për një jetë më të mirë dhe për të drejtën për arsim dhe edukim pa qenë të diskriminuar dhe të paragjykuar në shoqëri për shkak të gjendjes së tyre ekonomike dhe materiale<br><br>7. Në bashkëpunim me Drejtorin e shëndetësisë dhe QKMF kemi mbajt fushatën kundër kancerit të gjirit me moton "Eja edhe Ti", zbulimi i hershëm shpëton jetë!<br><br>Gjatë kësaj fushate kemi mbajtur ligjëratë sensibilizuese për metodat se si mundet edhe vete me zbuluar kancerin e gjirit , kemi shpërndarë flet palosje dhe kemi bërë listën e grave të cilat do e bëjnë edhe mamografin.<br><br>8. Në bashkëpunim me Komitetin Konsultativ | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | për persona me aftësi të kufizuar kemi organizuar takimine përbashkët me Komitetin Konsultativ nga Komuna e Kaçanikut.<br><br>Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i eksperiencave mes dy komunave dhe mundësit e bashkëpunimit në të ardhmen.<br><br>9.“Ndal Trafikimin me Qenien Njerëzore”<br><br>Me rastin e hapjes së Fushatës Kundër trafikimit me qenien njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit kam organizuar fushatë vetëdijësuese nga 18 tetor- 17 nëntor 2019, në të gjithë shkollave e Komunës së Prishtinës për ti informuar nxënësit për këtë dukuri negative mbi rreziqet nga trafikimi me njerëz dhe pjesëmarrja aktive e të gjithëve në parandalim dhe luftim të kësaj dukurie të arrijmë një efekt afatgjatë në vetëdijesimin dhe sensibilizimin e opinionit dhe referimi i rasteve.<br><br>Ky fenomen i cilësuar si “skllavëria moderne” ka marrë përmasa shqetësuese nëpër vendet e rajonit, pa përjashtuar këtu edhe Kosovën.<br><br>Kjo formë e krimit të organizuar në pjesën | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | më të madhe të shoqërisë prek fëmijët dhe gratë, ku janë më së shpeshti viktima të këtij krimi të rëndë, i cili e dehumanizon dhe i shkel të drejtat elementare të njeriut dhe dinjitetin e tij,<br><br>10. Me rastin e Ditës ndërkombëtare per te drejta e fëmijëve u mbajt Mbledhja solemne e Asamblesë së fëmijëve dhe u hap ekspozita me punimet e nxënëseve të dedikuar kësaj dite<br><br>11. Në kuadër të organizmit të fushatës "16 Ditët e Aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas" (simboli i kordeles së bardhe) , në bashkëpunim me Policin e Kosovës kemi mbajt ligjërata informuese në shkollat e mesme të larta të Komunës së Prishtinës dhe në fund edhe një takim të përbashkët me Grupin komunal Koordinuese kundër dhunës në familje.<br><br>12. Në bashkëpunim me Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara - Komunës së Prishtinës, më datën 3 Dhjetor, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të PAK, **është mbajtur** debat i hapur tematik lidhur me realizimin e të drejtave ligjore të PAK në nivelin lokal, si dhe obligimet institucionale për zbatimin e atyre të drejtave**.** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | PO<br><br>Jo , NJDNJ-BGj me organizimin e mbrendshëm është bashkuar me zyrën për Komunitete dhe kthim edhe pse këto dy Njësi rregullohen me ligj dhe rregullore të veçanta, prandaj si NJDNJ-BGJ nuk ka buxhet .<br><br>Aktivitet të ndryshme të cekura më lart | |
| 5.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 1. A ka hartuar komuna juaj Strategjinë kundër dhunës në familje, nëse po ju lutem të bashkangjiteni Startegjinë e miratuar?<br><br>2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit të | 1. Jo Komuna e Prishtinës nuk e ka hartuar Strategjinë kunër dhunës në familje , por zbatohen procedura standarde të veprimit për dhunën në familje në Kosovë;<br><br>2. Jo Komuna jonë nuk e ka hartuar Planin e Veprimit të Strategjisë kundër dhunës në familje<br><br>3. Gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2019 janë 72 raste të dhunës mbi baza gjinore | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Strategjisë kundër dhunës në familje, nëse po ju lutem të bashkangjiteni këtë Plan ?<br><br>3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj?<br><br>4.A ka themeluar komuna këshillin komunal për mbrojtën e viktimave te dhunës ne familje dhe baza gjinore, nëse po sa takime janë mbajtur?<br><br>5. A ka rritur komuna juaj buxhetin e ndarë për këtë vit për zbatimin e politikave për barazi gjinore në raport me vitin 2018? Nëse po, ju lutemi ofroni të dhënat (në shifra absolute dhe përqindje). Nëse jo, ju lutemi shpjegoni arsyet.<br><br>6. Cfarë ka ndërmarrë komuna juaj gjatë periudhës raportuese për ngritjen e kapaciteteve institucionale për | nga QPS;<br><br>4. Po, është formuar këshilli komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore, takimet mbahen çdo 3 muaj ose sipas nevojës;<br><br>5. Jo nuk ka buxhet , Zyrtarja për Barazi gjinore është në kuadër të NJDNJ dhe tani edhe e bashkuar me Zyren për komunitete dhe kthim;<br><br>6. Aktivitete e cekura me lart | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | zbatimin e politikave për barazi gjinore? Ju lutemi shpjegoni aktivitetet e ndërmarra. | | |
| 5.4.Të fuqizohet roli dhe pozita e femrës në shoqëri | **Njësia për të Drejtat e Njeriut** | 1. Sa është numri i femrave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj)?<br><br>2.Sa është numri total i përfaqësimit të femrave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë ?<br><br>3.A ka ndërmarrë Komuna juaj ndonjë veprim për rritjen e përfaqësimit të grave në | 1. Numri i femrave në pozita menaxheriale në shërbimin civil të Komunës së Prishtinës është 12, në grupin e të cilave nuk ka minoritete;<br><br>Shtatë (7) nga të lartëpërmendurat femra janë në pozitën e Drejtores'<br><br>**ADMINISTRATA E KOMUNES**<br>- Nga 549 punëtorë të angazhuar ne Administratë, 243 jane femra, 306 meshkuj (19 nga ta janë te komunitetit jo shumicë femra dhe meshkuj);<br><br>**QMF dhe AMF**<br>- Drejtore 1 (femër) | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | pozitat lokale të vendimmarrjes. Nëse po cilat janë ato? | - Shefe 11 (femra)<br>- Përgjegjëse, Infermiere përgjegjëse<br>25 (femra)<br>**SHKOLLA**<br>- Në Institucionet parashkollore janë tetë (8) drejtore – femra;<br>- Në SHFMU janë 24 Drejtore dhe zv.Drejtore femra;<br>- Në SHML janë tri (3) drejtore dhe zv.drejtore femra;<br>**Kuvendi i Komunës – Asambleja**<br>- Kuvendi i Komunës së Prishtinës i ka gjithsejtë 51 anëtare, nga ta 18 janë femra, 33 meshkuj; Ndërsa një anëtarë nga radhët e PDK-së, në bazë të deklarimit të dhënë, më 07.11.2019, jep dorëheqje të parevokueshme nga posti i anëtarit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, pra tani gjithsejtë janë 50 anëtarë deri ne zëvendësimin e tij; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 1. Po, nga 3 drejtore në fillim të mandatit për momentin kemi 7 femra; | |
| 5.5.Zbatimi i të drejtave pronësore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/ Zyra për Barazi Gjinore** | 1. Cilat janë veprimet që ka ndërrmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre? | 1. Zbaton udhëzimin adm. për regjistrimin falas të pronëse së përbashkët të dy bashkshortëve ku për periudhën raportuese janar – dhjetor 2019 kemi 180 regjistrime, ( 86+94) ne dy gjashtemujoret; | |
| 5.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** | 1.Sa raste të strehimit dhe të kompensimit të viktimave të trafikimit janë evidentuar në komunën tuaj?<br><br>2. A ka siguruar Komuna ndihmë për viktimat e kundër trafikimit ?<br><br>3.A ndanë Komuna juaj fonde të qëndrueshme dhe afatgjatë për ofrimin | DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE<br><br>1. Nuk kemi të evidentuar raste të trafikimit që është kompensuar;<br><br>2. Jo nuk ka pas ndonjë iniciativë për planifikim të ndonjë ndihme për rastet e trafikuara; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | e shërbimeve sociale?<br><br>4.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeqar për strehim Social. Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin? | 3. Buxheti i planifikuar i DMS-së për OJQ është 320,000 € për vitin 2019. Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfere për Shërbime Sociale dhe Rezidenciale;<br><br>Objektivat e përgjithshme është që në DMS Komuna e Prishtinës ofron përkrahje/Subvencione për personat në rast të varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të fatkeqësive natyrore, të sëmundjeve të rënda kronike, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe persona të moshës madhore, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara. DMS ndan ndihma te njehereshme momentale vetem nje here ne vit dhe ne raste te jashtëzakonshme;<br><br>DMS ofron përkrahje me Subvencione për pagesë familjeve me gjendje të rëndë sociale ekonomike të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit/strehimit. Pagesae qiarse ju behet nje here ne vite ne baze te rrgullores komunale per ndarjen e subvencioneve;<br><br>Gjithëashtu subvencionohen edhe OJQ | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | që ofrojnë shërbime të Mirëqenies Sociale nje here ne vit;<br><br>Duke i zbatuar sipas Rregullores e nxjerr nga Ministria e Financave për Subvencione të OJQ-së - MF-NR-04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik te OJQ-ve. (akom jemi ne proces te shpalljes se thirrjes publike per OJQ);<br><br>Planin tre-vjeqar të Strehim/Banimit Social Komuna nuk e ka të miratuar; | |
| 5.7.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal | **Drejtoria për Financa dhe Buxhet** | 1. A ka ndarë komuna juaj buxhet për mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë? Nëse po, sa është buxheti ?<br>2.A ndan Komuna juaj buxhet për personat e riintegruar? | 1. ZKK ka buxhet në vlere totale 177.417 euro<br><br>1. Komuna ka nda buxhete per ZKK<br><br>A. Paga dhe mëditje 40,000.00 €,<br><br>B. Mallra dhe shërbime 120,000.00 €,<br><br>C. Komunali 17,417.00 €,<br><br>Total 177,417.00 €,<br><br>1. Po nga programi i ZKK-se; | |
| 5.8.Të përmirësohet implementimi i Ligjit | **Zyra** | 1.A është rekrutuar stafi i nevojshëm dhe | 1. Në komunën tonë janë të angazhuar dy (2 ) | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| për përdorimin e gjuhëve | **ligjore/Zyra informimit** | profesional për përkthim?<br><br>2.Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët që përdoren nga komunitetet jo shumicë në komunën tuaj? | përkthues shqip – serbisht dhe anasjelltas;<br><br>2. Momentet kur intenziteti i punës ka qenë i madh, janë bërë përkthime me pagesë (përmes kontraktimit); | |
| **6.MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE** | | | | |
| 6.1.Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)** | 1. Cilat janë veprimet/aktivitetet që komuna juaj ka ndërmarrë lidhur me definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjëzimin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore? ( te ndahet veq e veq)<br><br>2. A është bërë studimi i fizibilitetit dhe projektit ideor në komunën tuaj për sa i përket themelimit të Muzeut të Natyrës? **(Prishtina dhe Fushë** | 1.Në kuadër të nismës thelbësore për ruajtje të trashëgimisë kulturore kemi vazhduar me marrëveshje bashkëfinancimi me nr.14-24/01-0053704/17të datës 07.03.2019 me Fondacionin Trashegimia Kulturore pa Kufi CHwB, kjo marrëveshje ka këto objektiva kryesore:<br>• Planifikimi dhe revitalizimi i Rrugës Model për Qëndren Historike të Prishtinës, që do të planifikuar ne kë të periudhe te finalizohet plani zbatues për "rrugën Model"<br>• -Plani i Konzervimit për Qendrën Historike.<br>• Mbeshtetje e përgjithshme në fushën e trashëgimisë kulturore, që i përket projekteve që lidhen me promovim të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Kosova)**<br><br>3.A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj?<br>**(Prishtina dhe Fushë Kosova)** | trashëgimisë kulturore, nënën e Prishtinës si dhe projektet që ndërlidhen me turizëm, arkitekturë dhe historik të qytetit.<br>Përveç marrëveshjes me CHwB, kemi bërë vazhdimi marrëveshje bashkëpunimi edhe me Swisscontactme datë 08.03.2019 me nr.14-024/01-555302/19 për inplementimin e strategjisë për turizëm, në gjetjen e modeleve të menaxhimit efikas të monumenteve kulturore, trajnimin e guidave ( cicëronëve) dhe zhvillimin e produkteve turistike.<br><br>Në kuadër të projekteve të konservimit është duke u punuar intenzivisht ne projektin zbatues për Rrugën Model në kuadër të Qendrës Historike të Prishtinës;<br><br>2. Muzeu i Natyrës është projekt i iniciuar nga Ministria e Kulturës dhe ne nuk kemi qenë palë e involvuar zyrtarisht, prandaj edhe nuk i kemi informatat për studimin e fizibilitetit;<br>3. Muzeu i Natyres ka ekzistuar si institucion dhe ka qenë aktiv në objektin ku sot ndodhet Muzeu Etnologjik, por sot është pasiv dhe jashtë funksionit. Pas vitit 1999 të gjitha artefaktet janë duke u ruajtur ne Muzeun Kombetar të Kosoves, kurse Ministria e Kultures është duke u marrë me rinisjen e tij si muze funksional. Komuna e Prishtinës përkatësisht Drejtoria e Kultures ka | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | interesim te jashtëzakonshëm për këtë projekt dhe është në dispozicion për çfarëdo bashkëpunimi në këtë drejtim me të gjitha institucionet relevante; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6.2.Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)** | 1. A ka komuna juaj Plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ? Nëse po Ju lutem ti bashkangjitni Planin?<br><br>2. A ka komuna juaj Planin e Veprimit për trashëgimi kulturore. Nëse po Ju lutem ti bashkangjitni Planin?<br><br>2. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?<br><br>3. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?<br><br>4. A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive te objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?<br><br>5. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? **(Vetem komunat qe kanë kisha)** | 1. Komuna e Prishtinës e ka përpiluar një draft plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore si dokument interrn që përcakton hapat dhe veprimet në 3 vitet në vijim. Ky draft plan për momentin nuk është në ueb-faqen e komunës;<br><br>2. Regjistër nga shkeljet e kaluara nuk është mbajtur në Komunë. Por në gjendjen e tanishme shumica e ndërtesave të trashëgimisë kulturore janë të neglizhuara nga pronarët dhe këtë e evidentojnë edhe raportet nga inspekcioni i Komunës. Kjo na ka shtyrë neve si institucion të ndërhyjmë, duke u fokusuar në ndërtesa ne iniciative si dhe për hartimin Planit të konzervimit në Qendrën Historike të Qytetit. Prishtina në regjionin e saj ka në përbërje 7 komuna: Prishtinën, Podujevën, Obiliqin, Drenasin, Lipjanin, Fushë Kosovën dhe në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme janë të listuara gjithsej 118 objekte, prej të cilave: 51 profane, 27 sakrale dhe 35 utilitare;<br><br>3. Ne si Drejtoria e kulturës kemi ndërmarrë masa të stabilizimit, mbrotjes dhe renovimit të ndërtesave të rrezikuara të trashëgimisë kulturore, duke bërë projektet e konservimit, pastrimin dhe evidentimin e ndërtesave, stambilizimin përmes skeleve dhe tjera formave profesionale në ndërtesa të trashëgimisë kulturore në Prishtinë;<br><br>4. Komuna ne periudhën janar-qershor 2019 nuk ka bërë ndonjë veprim lidhur më vendosjen e kamerave apo pajisjeve për monitorimin e sigurisë së objekteve të trashëgmisë kulturore, mirëpo ne disa | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës** | 1.Cilat janë aktivitetet që komunat kanë ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?<br>2. Cilat janë format e bashkëpunimit me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore? | Komuna e Prishtinës ka ndërmarr këto aktivitete lidhur me ndërgjegjësimin dhe promovimin e mbrojtjes se trashëgimisë kulturore si në vijim:<br>• Inicimi i hartimit të planit te konzervimit te Zonen Historike te Qytetit ne bashkëpunim me CHwB bazuar ne marrëveshjen e ne bashkëfinancimit;<br>• ka iniciuar rregullimin e shkollës së parë shqipe në Prishtinë, ku eshte bere pastrimi dhe tani Qendra Rajonale per Trashegimi eshte duke inicuar Hartimin e projetit te konzervimit;<br>• Relevimi dhe restaurimi i bibliotekës Hivzi Sylejmani dhe konvertimi në Muzeun Ibrahim Kodra eshte ne proces te hartimit te projektit;<br>• Projekti emergjent i shtëpisë së Sali Safqe, pas ndërprerjes se punimeve tani ne nashkpunim me IKMM presim rekomandimet si te vazhdohet tutje;<br>• Revitalizimi i rrugës Mehmet Kaçurri (Rruga model), kjo iniciative është proces të tenderimit bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit e që kemi me me Fondacionin Trashëgimia Kulturore Pakufij- CHwB, gjegjësisht evidentimi mbrojtja dhe restaurimi ; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | • Ish-objekti i kadastrit; ky projekt i iniciuar nga komuna është në proces të tenderimit për projektin ideor;<br><br>• Eshtë iniciuar edhe projekti për Muzeun e shtëpi shkolla (Herticët ) në lagjen Kodra e Trimave, që është në fazën e dytë të vlerësimit të Konkurs projektimit.<br><br>• Projektet të cilat janë ndërmarr në bashkepunim UNDP të përkrahur nga instrumenti për paqe dhe stabilitet i Bashkimit Evropian (IcSP/BE) projekti "Dialogu nderkomuniteteve përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse te Trashegimise Kulturore " përmes komponentes së parë të këtij projekti Rehabilitimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare per te nxitur dialogun- ndëretnik ne bashkëpunim me komunës e Prishtines janë ndërmarr këto projekte si në vijim :<br><br>• projekti për Varrezat Hebraike,<br><br>• Ish- Akademinë e Shkencave si dhe<br><br>• Parkun arkeologjik perballe Muzeut te Kosoves.<br><br>2. Bashkëpunimi me Komunën për pikën 1, QRTK dhe Komuna e Prishtinës kanë bashkëpunim të vazhdueshëm si dhe | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | konsultime dhe takime të vazhdueshme lidhur me çështje të trashëgimisë; | |
| **2. BLLOKU II: KRITERET EKONOMIIKE** | | | | |
| **1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT** | | | | |
| 1.1. Lehtësimi i procedurave të bërjes biznes në komuna | **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik** | 1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunën tuaj ? | • Sa i përket shërbimeve te integruara ne një pike Komuna e Prishtinës ofron sistemin One- Stop-Shop për qytetaret ne drejtorinë e urbanizimit;<br><br>Komuna e Prishtinës më 28.04.2016, ka arritur marrëveshjen e mirëkuptimit të lidhur në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunës së Prishtinës, Ujësjellësit Rajonal "PRISHTINA" dhe "KEDS", me anë të së cilës deklarohen se, në kuadër të institucioneve të tyre do të krijojnë "zyrën shërbyese", dhe ku komunikimi institucional do të jetë nëpërmjet atyre zyrave. Nga momenti i dërgimit të dokumentacionit të kompletuar nga Zyra Shërbyese e Komunës së Prishtinës në njërën nga kompanitë publike, këta të fundit në afat prej 5 ditësh do ti përgjigjen Komunës së Prishtinës; (bashkangjitur Marrëveshja ne PDF) | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Palët për prezantim të dokumentacionit të nevojshëm informohen përmes Zyrës Shërbyese / kontrollit. Në rast kur pala i është nënshtruar procedurës së pajisjes me Kushte Ndërtimore, atëherë, në dokumentin e Kushteve Ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit, palët njoftohen për procedurën dhe me dokumentacionin e nevojshëm, për pajisje me pëlqime nga kompanitë publike përmes sistemit "ONE STOP SHOP"<br><br>Përveç marrëveshjeve te arritura, Drejtoria e Urbanizmit këtë sistem ku kërkesat e mëposhtme janë hequr duke u zbatuar vetëm me kërkesë për Kushte Ndërtimore dhe Leje Ndërtimore, dhe ato si ne vijim:<br><br>- Pajisje me Pëlqimin për masat e mbrojtjes nga zjarri, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe<br>- Aplikimin për bashkimin të parcelave<br>- Aplikimi për ndarjen e parcelave kadastrale;<br>- Akti përcjellës ne Drejtori te Infrastrukturës etj. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
